



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 63, datë 17.04.2026

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTIT ZHVILLUES PËR OBJEKTIN:
“KOMPLEKS REZIDENCIAL DHE HOTELERI 1-5 KATE MBI TOKË DHE 1-3 KATE
NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË PALASË, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit” i ndryshuar, nenit 13/1 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Palasa Hill” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e subjektit zhvillues për objektin: “Kompleks rezidencial dhe hoteleri 1-5 kate mbi tokë dhe 1-3 kate nëntokë”, me vendndodhje në Palasë, Bashkia Himarë, nga subjekti zhvillues “Valona Konstruktion” sh.p.k., në subjektin zhvillues “Palasa Hill” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 28, datë 28.01.2025 të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADEL AJDA ROKA



Nënshkruar më datë 29/05 2026